

VENDIM
Nr. 749, datë 23.9.2020

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 695, DATË 31.7.2013, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË
PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË
PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR ‘ZGJERIMI I RRUGËS SË
ELBASANIT (FAKULTETI I HISTORISË DHE I FILOLOGJISË–UNAZA E
MADHE E TIRANËS)’”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në pikën 4, të vendimit nr. 695, datë 31.7.2013, të Këshillit të Ministrave, fjalët “... ndërsa pjesa e mbetur, në masën 83 911 577 (tetëdhjetë e tre milionë e nëntëqind e njëmbëdhjetë mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e shtatë) lekë, do të përballohet sipas mënyrës që do të përcaktohet me vendim të veçantë të Këshillit të Ministrave.” zëvendësohen me “... pjesa e mbetur, në masën 83 911 577 (tetëdhjetë e tre milionë e nëntëqind e njëmbëdhjetë mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e shtatë) lekë, do të përballohet nga fondet e Autoritetit Rrugor Shqiptar, sipas tabelës bashkëlidhur vendimit.”.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Autoriteti Rrugor Shqiptar për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe